



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 38

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 1 tetor 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 780 (3214), datë 2.7.2018	Me objekt daljen nga procedura e falimentimit e shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., me NIPT K66725001V, me seli në lagjen “Vasil Shanto”, rruga: “13 Dhjetori”, 7-4000, Shkodër dhe kthimin e saj në status aktiv.....	3
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 12616, datë 14.9.2018	Me objekt hapjen e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “Dobrej” sh.p.k.....	5

**VENDIM****Nr. 780 (3214), datë 2.7.2018****NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e përbërë nga: Hasan Selimi, gjyqtar, asistuar nga sekretare gjyqësore Gjystina Kolnikaj, sot, në datën 2.7.2018, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen tregtare që i përket:

KËRKUESE: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, përfaqësuar nga juristja Sirjana Bakushi

P. TRETË: Shoqëria “AR Europrojects” sh.p.k., përfaqësuar nga administratorja e falimentit znj. Shpresa Breçani dhe kreditorët: Kydrete Spahija, Elvin Beqiri, Sabah Bajri, shoqëria “Termo Mont”, shoqëria “R&T”, Renis Tershana, Gjon Radovani, Intesa San Paolo Bank dhe Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë.

OBJEKTI: Dalja nga procedura e falimentimit e shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., me NIPT K66725001V, me seli në lagjen “Vasil Shanto”, rruga “13 Dhjetori”, 7-4000, Shkodër dhe kthimin e saj në status aktiv.

BAZA LIGJORE: Neni 334 i Kodit të Procedurës Civile. Nenet 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijuese të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar).

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit si më lart, pasi realizoi mbledhjen përfundimtare të kreditorëve të falimentimit dhe dëgjoi ata dhe administratoren e falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., në falimentim, në lidhje me vijimësinë e procedurës dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN SE:

Shoqëria “AR Europrojects” sh.p.k. është një shoqëri tregtare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në datën 25.5.2006. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin tregtar në fushën e ndërtimeve dhe projekteve etj., sipas kërkesës së bërë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër për këtë shoqëri në falimentim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka hapur procedurat e falimentimit me vendimin e ndërmjetëm të datës 15.2.2015 dhe administratore e falimentimit është caktuar znj. Shpresa Breçani.

1. Me vendimin nr. 235 (612), datë 12.2.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkesit Drejtoria Rajonale e Tatimeve;

- Hapjen në orën 13:45, të datës 12.2.2015, të procedurës së falimentimit për shoqërinë “AR Europrojects” sh.p.k., me përfaqësues ligjor z. Arben Canole, me seli në Shkodër, “13 Dhjetori”.

- Emërimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “AR Europrojects” sh.p.k., znj. Shpresa Breçani, eksperte kontabël e regjistruar, e licencuar në fushën e administrimit të falimentit, me nr. 9 licence, datë 15.10.2012, me adresë: rruga “Jordan Misja”, p. “Sara-El”, shk. 1, ap. 1, Tiranë.

2. Gjatë zhvillimit të procedurës janë mbajtur mbledhje për raportim dhe mbledhje për verifikimin e pretendimeve, të cilat kanë përfunduar me miratimin e tabelave përkatëse të pretendimeve të kreditorëve të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k.

3. Me vendimin e ndërmjetëm me nr. regi. them. 339/1877/513/3192 (41201-03476-51-13), datë regi. 12.12.2013, “Për rimbursimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit dhe shpërblimin e administratorit të falimentimit”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së administratores së falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., në falimentim, Shpresa Breçani.

- Shpërblimin e administratores së përkohshme të falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., në masën 420.000 lekë (me TVSH).

- Rimbursimi i shpenzimeve të kryera nga administratori i përkohshëm i falimentimit në masën 239.000 lekë.

- Shpërblimin e administratores së falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., në falimentim, mbi masën e falimentimit të mbledhur nga data 9.7.2014–18.4.2018, sipas VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007, pika 3/“e”, në masën 3.070.692 lekë (pa TVSH).

- Rimbursimi i shpenzimeve të kryera nga administratorja e falimentimit gjatë procedurës në masën 623.300 lekë.

- Shpenzime të tjera për taksa e tarifa gjatë procedurës së falimentimit: 896.921 lekë.

- Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet personalisht administratores së falimentimit, Shpresa Breçani.



- Një kopje e këtij vendimi të shpallet publikisht në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me përjashtim të shumave të parashikuara, për efekt njoftimi.

- Teksti i plotë i këtij vendimi gjendet në Sekretarinë e Seksionit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë nga administratorja e falimentimit, debitori dhe çdo kreditor falimentimi, në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes së tij.

4. Kundër këtij vendimi nuk ka pasur asnjë ankim nga palët e interesuara.

5. Gjatë procedurës së falimentimit të shoqërisë, në datën 15.12.2017, është mbajtur mbledhja e kreditorëve, në të cilën u diskutua për daljen e shoqërisë nga procedura e falimentimit, ku shtatë nga përfaqësuesit e kreditorëve dhe administratorja e falimentimit ranë dakord për daljen e shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., nga procedura e falimentimit.

6. Për sa i takon realizimit të kontratës për pronën “Apartament 69.68 m², në zonën kadastrale 8591, me nr. pasurie 2/1132+1-8, vol. 49, f. 2, midis shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., shoqëri në falimentim dhe blerëses znj. Kydrete Spahia, nuk është bërë e mundur lidhja e kësaj kontrate, pasi pala blerëse nuk ka rënë dakord për pagesën e kështit të tretë dhe të fundit për shumën prej 3.392 eurosh (shumë e cila është pjesë e masës së falimentit dhe me realizimin e kontratës t’i kalojë kreditorit të siguruar “Intesa San Paolo Bank” sh.a.

7. Miratimi i raportit të administratores së falimentimit në datën 5.6.2018 për shoqërinë “AR Europrojects” sh.p.k., shoqëri në falimentim, për shpërndarjen përfundimtare të masës së falimentimit të shoqërisë.

8. Në kushtet kur janë lidhur kontratat e shitjes dhe ka përfunduar shitja e masës së falimentimit dhe është depozituar shuma në llogarinë bankare të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., shoqëri në falimentim, shumë e cila është shpërndarë sipas dispozitave që përcakton ligji, në detyrën e administratores së falimentimit, u kërkua përfundimi i procedurës së falimentimit, pasi është kryer shpërndarja përfundimtare nga administratorja me pëlqimin e

vullnetin e lirë të kreditorëve e për këtë marrëveshje është njoftuar seksioni tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe i është kërkuar unanimisht dalja nga procedura e falimentit dhe pagesat e prapambetura të tatim-taksave në qytetin e Shkodrës.

9. Bazuar në nenin 163 të ligjit për falimentimin, sipas së cilit: “1. *Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendosi mbylljen e procedurës së falimentimit.* 2. *Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht.*”.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306–308 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijuese të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., me NIPT: K66725001V, me seli në lagjen “Vasil Shanto”, rruga “13 Dhjetori”, 7-4000, Shkodër.

2. Miratimin e raportit të administratores së falimentimit të paraqitur në datën 5.6.2018, ora 11:00, së bashku me shpërndarjen përfundimtare të masës së falimentimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil, para kreditorëve të shoqërisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

3. Kthimin e shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k. në status aktiv.

4. Largimin e administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani, si pasojë e përmbushjes së detyrave.

5. Realizimi i kontratës përfundimtare të shitjes për pasurinë me nr. 2/1132+1-8, vol. 49, f. 2, midis shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., shoqëri në falimentim dhe blerëses znj. Kydrete Spahia të bëhet jashtë procedurës së falimentimit dhe kështu i tretë në shumën 3.392 euro t’i kalojë kreditorit të siguruar “Intesa San Paolo Bank” sh.a., sipas deklaratës së saj për heqjen e sekuestros konservative.

6. Administratorja e falimentit të subjektit “AR Europrojects” sh.p.k., znj. Shpresa Breçani, nga masa e falimentit të paguajë detyrimin pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër nga viti 2008 e në vazhdim, bashkë me interesat që rrjedhin prej këtyre detyrimeve taksore.



7. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

8. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

9. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet personalisht administratorës së falimentimit znj. Shpresa Breçani.

10. Një kopje e këtij vendimi t’u njoftohet kreditorëve të falimentimit të shoqërisë “AR Europrojects” sh.p.k., shoqëri në falimentim dhe konkretisht, kreditorëve: Kydrete Spahija, Elvin Beqiri, Sabah Bajri, Renis Teršana, shoqëria “Termo Mont”, shoqëria “R&T”, Gjon Radovani, Intesa San Paolo Bank dhe Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë.

11. Bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, neni 7 (Ankim i veçantë), pika 1, vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit është menjëherë i ekzekutueshëm.

12. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të masës së falimentimit.

13. Kundër vendimit palët në procedurën e falimentimit kanë të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar ose nga dita e nesërme e shpalljes publike në faqen zyrtare të internetit të gjykatës dhe në Buletin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

U shpall në Shkodër, sot në datën 2.7.2018.

SEKRETARE
Gjystina Kolnikaj

GJYQTAR
Hasan Selimi

VENDIM

Nr. 12616, datë 14.9.2018

PËR ZHVILLIMIN E FAZËS SË DYTË TË HAPJES SË PROCEDURAVE TË FALIMENTIMIT

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtar: Ervin Pollozhani

Pasi u njoh me aktet e çështjes tregtare nr. 12616, datë 13.9.2018, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë.

PERSONA TË TRETË: Shoqëria “Dobrej” sh.p.k., me seli në adresën: rruga “Besim Imami”, nr. 50, Tiranë, me NIPT: K61627018M.

OBJEKTI: Hapja e procedurave të falimentimit për subjektin, shoqëria tregtare “Dobrej” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

VËREN:

Se, me kërkesën drejtuar gjykatës, pala kërkuese Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, ka kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k.

Me vendimin nr. 362, datë 26.1.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në prova dhe në ligj.*

Mbi ankimin e palës kërkuese, Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 572, datë 28.10.2016, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. 362, datë 26.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesës për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Dobrej” sh.p.k.*

Pas këtij vendimi, dosja fizikisht është paraqitur nga sekretaria gjyqësore pranë trupit gjykues vetëm në datën 13.9.2018, duke kryer gjykata, vetëm pas kësaj date, veprimet e saja ligjore për fazën e dytë të kësaj procedure falimentimi.

Në lidhje me parashikimet ligjore, në përputhje me rastin konkret, Gjykata vëren, se neni 18/4, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon: “Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, brenda



afateve të treguara në pikën e këtij neni, vendos:

c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit”.

Neni 26, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon: 1. *Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit.* 2. *Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit. ç) të dhënat e parashikuara në nenin 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës ... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit. Në përfundim, pas analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se:*

Sa më lart dhe në kushtet kur është vendosur pranimi i kërkesës dhe hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., të gjithë kreditorët e shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi gjyqësor.

Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të ligjit “Për falimentimin”, të ndryshuar, urdhërohet:

Publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit, shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të

paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar).

Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

Publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Publikimi dy herë i vendimit të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shekulli”.

Bazuar në nenin 8/2, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), për kryerjen e njoftimeve dhe shpalljeve publike sipas nenit 9, të ligjit dhe caktimin e mbledhjeve brenda afateve të parashikuara në këtë vendim, ngarkohet administratorja e falimentimit Lindita Kikino. Shpenzimet në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen masës së falimentimit. Si rrjedhim, një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet dhe administratores së falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., znj. Lindita Kikino.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “Dobrej” sh.p.k., të znj. Lindita Kikino, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 12, datë 16.10.2012, me adresë: Rruga e Kavajës, pallati 12-katësh, shk. 3, ap. 15, Tiranë.



2. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Dobrej” sh.p.k. të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

3. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Dobrej” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

4. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Lindita Kikino.

5. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

6. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

7. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

8. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., znj. Lindita Kikino.

9. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901,

datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

16. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

17. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Dobrej” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shekulli”.

U shpall në Tiranë, sot në datën 14.9.2018.

SEKRETARE
Lusjana Fezollari

GJYQTAR
Ervin Pollozhani

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2018